

## **Gjermanisht, lexim, shkrim/gjermanisht, lexim**

### Detyrat e mësimimit dhe të arsimit

Mësimi I gjermanishtes ka për detyrë t'i nxisë nxënësit – duke marrë parasysh premisat individuale për të mësuar – në gadishmërinë dhe aftësinë e tyre në mirëkuptimin ndërnyjerëzor përmes të mësuarit me dhe për gjuhën. Në detaje bëhet fjalë për,

- zgjerimin e gjuhës individuale të fëmijës në një gjuhë standarte
- ushtrimi dhe forcimi I përdorimit të saktë të gjuhës me gojë dhe me shkrim
- nxitja e të lexuarit dhe e konfrontimit me pjesën e lexuar
- përkrahja dhe mundësimi I një përdorimi krijues të gjuhës
- lejimi I fitimit të disa njohurive bazë në funksionin dhe strukturën e gjuhës sonë
- ndërmjetësimi I teknikave të punës dhe mësimimit, të cilat aftësojnë në një masë gjithnjë e në rritje arsimimin e pavarur

Lënda mësimore e gjermanishtes ndahet në proceset e mëposhtme:

- të folurit
- të lexuarit
- të shkruarit (vetëm niveli fillestar)
- formulimi I teksteve
- drejtshkrimi
- vrojtimi I gjuhës

Kjo ndarje e gjuhës në pjesë qartëson strukturat e temave dhe zbatimin e lëndës të linjave të planit mësimor, por nuk duhet t'i kundërvihet në asnjë mënyrë një lidhjeje të kuptimshme të proceseve të të mësuarit. Kjo I mundëson kështu mësuesit një mësim të përshtatshëm për fëmijët dhe lëndën.

Në nivelin e 2-të fillestar procesi i të shkruarit i përshtatet temës mësimore të edukimit figurativ, kategorizimi i nëndisiplinave të tjera mbetet i pandryshuar.

### *Të folurit:*

Të folurit është një nga proceset më të rëndësishëm të mësimimit të gjermanishtes, që ndahet në 5 fusha detyrash, të cilat përfshijnë synime

thelbësore dhe afatgjata. Detyra parësore e procesit të të folurit është të ngrej dalëngadalë gadishmërinë dhe aftësinë e nxënësit në komunikimin gojor dhe t'i çoj ata drejt një përdorimi mundësisht të sigurtë të gjuhës standarte.

#### *Të lexuarit:*

Mësimi I leximit në nivelin e 1-rë fillestar ka për detyrë, t'u ndërmjetësojë nxënësve aftësinë themelore të leximit dhe me këtë të mundësojë përballjen dhe konfrontimin me tekstet. Gjithnjë e më shumë nxënësit po e kuptojnë të lexuarin si një kalim domethënës për në kulturën tonë, veçanërisht një mjet thelbësor në marrjen e informacioneve dhe bisedimit

Në mësimin e leximit në nivelin e 2-të fillestar nxënësit duhet të mësojnë që përmes leximit dhe përballjes me atë që lexojnë për përvojat reale të jetës, ata mund të thellojnë mirëkuptimin për veten e tyre dhe të tjerët, si dhe të informojnë veten dhe të bisedojnë me të tjerët.

Përballja dhe konfrontimi i shumëanshëm me tekste të llojeve të ndryshme, I shërben fazës përgatitore për arritjen e pjekurisë në procesin e të lexuarit. Në këtë kontekst është për t'u zgjeruar dhe forcuar aftësia e të lexuarit tek nxënësit.

#### *Të shkruarit (vetëm në nivelin e 2-të fillestar):*

Detyrë e mësimin të shkrimit është instruktimi I nxënësve në përdorimin e sistemit të shenjave grafike dhe konvencionale themelore. Aty ata duhet të mësojnë, se të shkruarit është një formë e komunikimit dhe dokumentimit. Në veçanti mësimi I shkrimit duhet të çoj në zotërimin e sigurtë të sistemit tonë të shkrimit.

#### *Hartimi I teksteve:*

Në procesin e hartimit të teksteve, nxënësit duhet të shprehin gjithnjë e më shumë në mënyrë të pavarur në bazë të gadishmërisë së tyre rrëfyese dhe aftësive të fituara gjatë procesit të të folurit, të të shkruarit dhe drejtshkrimit dhe pikërisht jo vetëm lidhur me vehten p.sh. për përjetimet, vrotimet, por edhe lidhur me partnerin p.sh. dëshirat, pyetjet; në nivelin e 2-të fillestar lidhur edhe me tema të ndryshme.

#### *Drejtshkrimi:*

Detyrë e mësimin të drejtshkrimit është të motivojë nxënësit në shkrimin sipas rregullave, ndërmjetësimi I njohurive themelore të drejtshkrimit dhe zgjerimi I vazhdueshëm në të ardhmen I aftësisë drejtshkrimore, t'i çoj ata

në dallimin dhe përdorimin e rregullave të thjeshta dhe t’I ndërmjetësojë atyre një teknikë kontrolli mundësisht të përdorshme.

### *Vrojtimi I gjuhës:*

Detyrë e vroitimit të gjuhës është ndërmjetësimi dalëngadalë në rritjen e gjykimit për strukturën dhe funksionin e gjuhës sonë.

## Lënda mësimore

### **Niveli i 1-rë fillestar (niveli I 1-rë dhe I 2-të shkollor**

#### *Të folurit*

Si pika kyce brenda fushave të vecanta të detyrave deri në fund të klasës së 2-të në tregim, rrëfim, dëgjim vlejné:

- në tregim dhe rrëfim të dëgjohen të tjerët me vetëdije dhe të mund të shprehen mbi atë që dëgjuan;
- në të shprehurin lidhur me një situatë
- në situata të llojeve të ndryshme të veproj shprehimisht me vënd;

#### Në bisedë

- t’I drejtohen njëri-tjetrit në forma të ndryshme bisedore gjatë të folurit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit;
- të kuptojnë, që në të folurin me njëri-tjetrin duhet të vendosen rregulla, prandaj duhet të bihet dakord dhe të zbatohen rregulla bisede të thjeshta;
- të përdoren dalëngadalë në biseda format e të shprehurit dhe mjetet gjuhësore të fituara në shkollë;

#### Në ushtrimin e gjuhës (zgjerimi I aftësive shprehëse)

- Zgjerimi I fjalorit në rrafsh të ndryshme (kuptimi I fjalës, fusha e fjalisë, familje fjalësh, koncepte kryesore etj)
- Disponimin e modeleve të fjalive më tepër të përdorëshme dhe orientimi dalëngadalë drejt gjuhës standarte;

#### Në ushtrimin e të folurit (të folurit e qartë)

- ndërtimi I saktë I tingujve si dhe të mund të artikuloen mirë fjalët dhe tekstet
- të mund të flasin me një gjuhë të pasur me shprehje.

#### Tregimi, rrëfimi, dëgjimi

### Motivimi:

Zhvillimi I kënaqësisë dhe gadishmërisë për të treguar, rrëfyer dhe dëgjuar në një atmosferë çlodhëse

Të kapen dhe krijohen situata të përshtatshme, të cilat të nxisin të treguarin.

### Rrëfimi I përjetimeve, vrojttimeve dhe ndjenjave

- të tregohet për përjetimet, ndodhitë dhe vrojtimit personale
- të flitet për foto dhe histori figurative
- të shprehen ndjenjat dhe ndjesitë personale si dhe ato të të tjerëve, të perceptohen dhe kuptohen p.sh. përmes ngushëllimit, qetësimit etj. si këto dhe të ofrohet ndihmë verbale.

### Marrëdhënie krijuese dhe në formë loje me gjuhën

- të provohen lojra tingujsh dhe fjalësh, sajime rimash
- sajimi dhe ndryshimi I emrave, nocioneve, historive etj.

### Dëgjimi

- Dëgjimi I tregimit të mësuesit dhe nga kjo të fitohen nxitje për tregimin personal. Të dëgjohet me vëmendje tregimi I nxënësve të tjerë.
- Të zgjohet dhe të nxitet gadishmëria dhe aftësia e marrjes përmes situatave treguese të përshtatshme (tregimi ne rreth, parashikimi I kohëve të rregullta të tregimit, eventualisht ushtrime për vëmendjen dhe të këtilla)
- Ajo që është dëgjuar të ritregohet (pa pretendimin për saktësi dhe plotësi)
- Të shprehurit për atë që është dëgjuar (p.sh. të bëhen pyetje).

Të folurit lidhur me një situatë:

Mbledhja e eksperiencave në situata të thjeshta bisedore, kapërcimi I situatave shprehimisht.

Kapja e situatave bisedore dhe provimi në lojë

- përshëndetja, ndarja, kërkimi ndjesë
- informimi dhe dhënia e informacionit
- shprehja e propozimeve (pozicioni i nxënësve në klasë, ndërtimi I pushimeve, lojrave, ndërtimi I kohës së lirë)

Biseda:

Futja në biseda; forma paraprake të bisedës:

Biseda në formë loje me njëri- tjetrin (p.sh.lojra njohjeje , gjëgjëza dhe lojra me pyetje, lojra duke dëgjuar njëri-tjetrin, lojra me përcjelljen e fjalës nga njëri tek tjetri.

Forma të thjeshta komunikimi ( thirrja e mëtejshme bisedë në formë zinxhiri, rreth elektoral etj.)

Sigurimi hap pas hapi I formave të thjeshta të folurit me njëri-tjetrin, hyrja në një bisedë, vazhdimi e të tjera si këto

Shkollimi I të dëgjuarit dhe të kuptuarit

Nga perceptimi nëpërmjet dëgjimit të vetëdijshëm dhe dëgjimit të njëri – tjetrit.

Kuptimi, rënia dakord dhe zbatimi i disa rregullave të rëndësishme në biseda:

Kuptimi I rëndësisë së rregullave në bisedë përkatësisht rënia dakord dhe zbatimi (p.sh. të japësh fjalën, ta shohësh dhe dëgjosh folësin, ta lësh të flasë, të mos e përqeshësh folësin kur ai thotë dicka të papërshtatshme a të pakuptueshme, të mund të argumentojë mendimet e tij personale)

Drejtimi në forma të ndryshme bisede

Biseda dyshe, në grup, në rreth për tema nga sferat e interesave dhe eksperiencave të fëmijëve ose nga ndeshja me fenomeneve në sfera të ndryshme të jetës ose dhe vetë të folurit me njëri – tjetrin ( p.sh. lojrat e Kasperit).

Ushtrimi I gjuhës (zgjerimi I aftësive gjuhësore):

Zgjerimi dhe diferencimi I fjalorit

Të folurit për objekte, figura e të njëjta si këto: përshkrimi me fjalë i veprimtarive, zhurmave, vrojtimeve etj.

Ndërthurja e elementëve gjuhësorë të mëparshëm në njësi të reja fjalësh dhe kërkimi I kuptimit.

Kufizimi I kuptimit të fjalive, përcaktimi kuptimor p.sh. përmes antonimeve përkatëse (klein - groß) ose përmes fushave të vogla gjuhësore.

Të ushtrohen modele fjalish të sakta;

Ndërtimi I fjalive analoge , të cilat përdoren shpesh me gabime, vecanërisht format e gabuara, të cilat dalin nga ndryshimi ndërmjet dialekteve dhe gjuhës standarte.

Ushtrimi I të folurit (të folurit e qartë):

Të folurit e natyrshëm dhe me shprehi:

Nxitja dhe forcimi I të folurit të natyrshëm të fëmijëve.

Ndërtimi I gjuhës të pasur me shprehi (p.sh. përkrahja e emocioneve, mendimeve, interesave përmes mjeteve shprehëse gjuhësore.)

Të folurit qartë:

Zbatimi I vetëdijshëm I artikulimit gjatë të folurit:

Përsëritja e fjalive ngatërruese dhe teksteve të artikuluar njësoj, lojra gjuhësore, ushtrime për dallimin e tingujve (p.sh. sinken – singen, reden – retten, Liebe – Lippe)

Të folurit me kuptim dhe sipas modelit të një teksti

Të folurit për rimat, vargjet dhe poezi të shkurtra.

Recitimi i lirë i vargjeve dhe poezive të shkurtra.

Dialekt – gjuhë standarte

Të krahasohen dialekti dhe gjuha standarte; të përcaktohen ngjashmëritë dhe ndryshimet.

Të lexuarit

Gjatë punës mësimore duhet të synohet , që nxënësit deri në fund të klasës së dytë

- të kenë mundësisht të zhvilluar një motivim të vazhdueshëm për të lexuarin;
- të jenë në gjendje të lexojnë rrjedhshëm tekste me shkrime të përziera dhe të përshtatshme për moshën

Plani mësimor I shkollës popullore, pjesa e shtatë, detyrat formuese dhe mësimore si dhe lënda mësimore dhe parimet didaktike të materialeve të detyrueshme të shkollës popullore dhe të nivelit të lartë të shkollës popullore, shkolla fillore – gjermanisht, leximi, shkrimi /gjermanisht, leximi Gjëndja : shtator 2001

- të mund të kapin kuptimin e këtij teksti
- të mund të përballen në një mënyrë të thjeshtë me tekstin

Leximi I parë (rezultatet bazë):

Rezultateve bazë të poshtëpërmendura u takon në kuptimin e ngushtë të fjalës një kuptim I vecantë si kusht paraprak për mësimin e leximit të parë. (lidhur me këtë shih dhe parimet didaktike)

Motivimi I të lexuarit

Masa të përhershme dhe të qëllimshme për rritjen e dëshirës për të lexuar dhe ruajtjes së kësaj dëshire.

Nxitja e gjuhës

Masa të plota dhe të qëllimshme për zhvillimin e gjuhës; përkrahje e ndërsjelltë e mësimit gojor të gjuhës dhe të mësimit të të lexuarit.

Motorika e të folurit

Të folur I artikuluar, vrojtimi I ndërtimit të tingujve

Afëtsia e ndarjes dhe dallimit akustik

Ndarja e gjuhës së dëgjuar në fjalë; dallimi i fjalëve që tingëllojnë njësoj dhe rinjohja e mëvonshme e tyre. Njohja e tingujve të vecante, dallimi nga të tjerët dhe rinjohja e mëvonëshme. Dallimi i rimave të thjeshta, fiksimi i tyre dhe ndërtimi nga vetë nxënësit.

Aftësia vizuale e dallimit dhe ndarjes

Dallimi I hollësirave në foto dhe ridallimi I mëvonshëm i tyre. Perceptimi i ndarjes në tekste të shtypura dhe të shkruara, dallimi I disa fjalëve nga të tjerat dhe riidentifikimi I mëvonshëm i tyre

Karakteri simbolik I shkrimit dhe I shenjave të tjera

Të kuptuarit që shkrimi dhe shenjat e tjera (p.sh. shenjat e qarkullimit) kanë dhe domethënie të tjera, të cilat mund t'i gjejmë përmes leximit.

## Konceptet themelore

Fjala, tingulli, shkrimi, shkronja; majtas, djathtas, sipër, poshtë, para, prapa dhe të tjera si këto.

## Mësimi I leximit të parë (procesi mësimor)

Pavarësisht nga metoda e zgjedhur dhe shkrimi fillestar, mësimi I leximit të parë në nivelin e 1- rë fillestar, përmbledh në të vërtetë më shumë hapa pune, renditja e të cilave nuk i përmbahet asnjë rendi metodik.

Ushtrime për ndarjen akustike, motorike të të folurit, ndarja vizuale e fjalive dhe e fjalëve në fjali.

## Ndarja e fjalive në fjalë

Të folurit, të krahasuarit dhe dallimi I fjalëve që tingëllojnë njësoj

Të dëgjuarit dhe të folurit e tingujve dhe grupeve të tingujve.

Konstatimi I grupeve të njëjta të shkronjave në fjalë të ndryshme, karakterizimi dhe dallimi I tyre nga të tjerat.

Copëzimi I fjalëve përmes ushtrimeve formuese dhe shformuese.

Shkëmbimi I tingujve dhe gërmave dhe lejimi I krijimit të fjalëve të reja.

Kapja e renditjes tingull – gërmë në variantet dhe cilësitë e tyre të ndryshme; zotërimi I gërmave

Në ushtrime të shumëllojshme renditja e një tingulli përkatës për çdo shkronje dhe artikulimi I tyre (p.sh.gjetja, konstatimi, emërtimi, seleksionimi dhe dallimi I shkronjave etj.)

Përdorimi I shkronjave të caktuara për më shumë se një tingull (p.sh. sehen und Strasse)

Renditja e shkronjave të ndryshme përkatësisht grupe shkronjash për të njëjtin tingull (p.sh. shkronjat e mëdha – shkronjat e vogla)

## Memorizimi dhe ridhënia e fjalëve dhe grupeve të shkronjave

Fiksimi I fjalëve të zgjedhura përmes ofrimit disa herë të figurës shkrimore dhe tingëllore si dhe ridhënia e tyre në mënyrë motorike.

Ushtrime për rinjohjen e shpejtë të fjalëve dhe grupeve të shkronjave.

## Bashkëleximi ndërtues

Bashkëleximi ndërtues së pari I fjalëve të njohura e më pas i fjalëve të panjohura, kapja e kuptimit të tyre.

Të ndërtohen dhe lexohen fjalë pa kuptim.

Ushtrime të shumëllojshme formuese dhe shpërbërëse.

Ndryshimi i kuptimit të një fjale përmes heqjes dhe shtimit të shkronjave në fjalë të njohura dhe më pas të panjohura. Gjetja e elementëve të njohur në fjalët e reja dhe përdorimi i tyre si ndihmë gjatë leximit

Formimi dhe ndryshimi i fjalive me fjalë të njohura dhe të sapomësuar.

Kapja e kuptimit të tyre përkatësisht ndryshimi i tij.

Leximi i përparuar

Rritja e sigurisë dhe rrjedhshmërisë në të lexuar

Ushtrime të shumëllojshme për një shqiptim të mirë

Lexim përmbledhës i teksteve në hapa kuptimorë gjithnjë e më të mëdha, p.sh. përmes ushtrimeve në „lexim blic“.

Marrja parasysh e shenjave më të rëndësishme të pikësimit

Ushtrime për kapjen e kuptimit gjatë të lexuarit

Kalimi nga leximi me zë të teksteve në atë pa zë

Përgjigje pyetjesh rreth tekstit të lexuar. Klasifikimi I udhëzimeve të shkruajtura në të rëndësishme dhe të parëndësishme, kuptimi i kërkesave dhe I të tjerave si këto.

Ndeshja me tekste letrare në situata leximi mundësisht të natyrshme.

Histori për ambjentin, përralla, lirika për fëmijë, skena të shkurtra dramatike etj.

Përfshirja e leximeve private

Ushtrimet e para për të lexuarin dysh, ndërtues të kuptimit (leximi me zë), të teksteve të paraushtruara në situata leximi të natyrshme

Tekste letrare

Tekste të përdorimit të gjerë (p.sh. udhëzues, ftesa, kërkesa, këshilla, urdhëresa, pyetje, lista, shënime)

Leximi I shënimeve personale dhe atyre të nxënësve

Përgatitja e përballjes së pavarur me tekste të llojeve të ndryshme  
Biseda dhe diskutime për përpunimin e kuptimit, pozicionimet, krahasimet, kundëvëniet, ndryshimet dhe vazhdimet plot fantazi.

Të shkruarit

Gjatë punës mësimore duhet të synohet, që nxënësit deri në fund të vitit të 2-të shkollor

- të mund të shkruajnë shkronjat, shifrat dhe shenjat në një formë të përafërt nga paraqitja me shkrimin shkollor austriak (kjo nuk përjashton mundësinë, që nxënësit të mësohen edhe me shkrimin e shtypit);
- të mund të shkruajnë tekste të shkurtra të lexueshëm nga paraqitja;
- Dallimi I shenjave për një shkrim të vazhdueshëm.

Nxënësi duhet të forcojë kushtet paraprake bazë për mësimin e të shkruarit dhe së paku t'i zhvillojë ato më tej në proceset e mëposhtme:

Motivimi I të shkruarit

Entuziazmi në figurën grafike, në realizimin mundësisht të saktë të formave grafike dhe në mirëkuptimin e arritur nëpërmjet shenjave grafike.

Trajnimi I motorikës të të shkruarit

Ushtrime shtendosjeje, veçanërisht për muskulaturën e shpatullave, krahëve, dorës dhe gishtave; gjithashtu ushtrime me të 2 duart; lojra me gishta dhe të tjera

Bartja e proceseve të lëvizjes nga motorika e të shkrurit në vija të trasha në drejtim të motorikës së shkrimit të hollësishëm

Ushtrime për fuqizimin e muskulaturës së duarve dhe të gishtave (Masazh, palosje, përkulje, formëzim, shkëputje dhe të këtitilla)

Kuptimi themelor i koncepteve për drejtimet dhe format e lëvizjes

Lidhur me trajnimin e motorikës së rëndë dhe të imët:

Poshtë, lart, jashtë, tëposhtë, majtas,, djathtas, pjerrtas:

në mes, përmbi, poshtë;

drejt, këndor, rrumbullak, me majë

Mësimi i koordinimit sy-dorë

Marrja dhe zbatimi mundësisht i përpiktë i ecurive të proceseve të paradhëna të lidhura me njëri – tjetrin

Marrja dhe kryerja më vonë mundësisht me saktësi i një serie lëvizjesh ritmike të paradhëna

Kryerja mundësisht me saktësi i lëvizjeve sipas modelit

Ushtrime sipas modeleve të dhëna

Qëndrimi gjatë të shkruarit; përdorimi i mjeteve të ndryshme dhe materialeve shkrimore

Ndihma dhe këshilla për pozicionin e trupit dhe të dorës

Mbledhja e eksperiencave në lidhje me

përdorimin e mjeteve të ndryshme shkruese mbi sipërfaqje të ndryshme

Riprodhimi dhe shkrimi i formave bazë të shkrimit fillestar; p.sh. ushtrimi i elementëve të formave bazë të lëvizjeve të shkrimit;

Parapërgatitja e kuptimit të shenjave

Paraqitja e shenjave të thjeshta (p.sh. shenjat e qarkullimit, simbolet) dhe verbalizimi i domethënies së tyre

Nga këto ushtrime bëhen qartësisht të spikatura dallimet në rendiment. Ato japin këshilla , se në cilat procese janë për t'u përkrahur individualisht nxënësit.

Në lidhjet reciproke ndërmjet të mësuarit të leximit, të shkrimit dhe drejtshkrimit duhet të merret parasysh por edhe duhet mbajtur llogari për përparimet e ndryshme të fëmijëve në keto procese.

Pavarësisht nga metoda e zgjedhur dhe shkrimi fillestar, mësimi i të shkruarit në nivelin e 1-rë fillestar përfshin disiplinat e mëposhtme:

Realizimi i shkronjave dhe shifrave sipas formës dhe ecurisë së saktë të lëvizjes

Nga elementët e formës dhe të lëvizjes krijohen shkronjat dhe shifrat; ndryshimi i madhësisë së shkrimit dhe i mjetit të shkrimit

Shkrimi në mënyrë të lexueshme i fjalëve dhe fjalive

Lidhja e shkronjave në fjalë dhe fjali

Mësimi i shkrimit si një veprimtari kuptimplotë

Leximi i shpeshtë i asaj që është shkruar nga vetë nxënësit

Në shkrimin e dorës: tregimi dhe përshkrimi i ecurive të vështira të lëvizjes si p.sh. ndryshimi i drejtimit, lidhjet e shkronjave  
Shkrimi i vazhdueshëm i fjalëve si të plota; orientimi në të shkruar (të shkruarit nga imagjinata)

Automatizimi i vazhdueshëm i proceseve të të shkruarit  
Përshpejtimi dalëngadalë i ecurisë së lëvizjeve, p.sh. përmes të ndjekjes nga pas të mënyrës së lidhjeve të shkronjave dhe fjalëve të shkurtra  
Automatizimi i lëvizjeve të shkrimit, në mënyrë që shkrimi të zotërohet lirshëm

Shkrimi i rregullt dhe sipas formës  
Ruajtja e rregulla formale gjatë shkrimit; p.sh.pjerrësia e këndit të shkrimit, lidhja midis gjatësisë së sipërme dhe të poshtme; distancën e njëjtë midis fjalëve dhe rreshtave; respektimi i hapësirave anësore

Lidhja midis shkrimit të shtypit dhe shkrimit të dorës  
Krahasimi me njëri – tjetrin i shkrimit të shtypit dhe atij të dorës; kalimi në klasën e dytë i fjalëve dhe teksteve nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Hartimi i teksteve

Si pika kyce të fushave të veçanta të detyrave deri në fund të klasës së dytë mund të shihen

- zhvillimi i entuziazmit në hartimin e teksteve;
- hedhja në letër e rrëfimeve, dëshirave, pyetjeve, përgjigjeve e të këtilla si këto;
- shkrimi në fjali të shkurtra i përjetimeve, vrojttimeve personale dhe të ngjashme me këto;
- shkrimi për persona, kafshë, objekte, procese veprimesh dhe rethana;

Ushtrime parapërgatitore dhe shoqëruese për hartimin e teksteve

Orjentimi dalëngadalë i tregimit dhe rrëfimit me gojë të nxënësve në formën e teksteve të shkurtra me shkrim

Kopimi i teksteve të shkurtra të paradhëna, por edhe fjali dhe grupe fjalësh të veçanta dhe këto sipas rastit të shkruhen edhe pa model.

- Dallimi nga i të rëndësishmes nga ajo më pak e rëndësishme

Renditja e fjalëve të çrregullta në një fjali të kuptimshme dhe renditja e fjalive të paradhëna në një tekst të kuptimshëm

Gjetja dhe shkrimi i titujve të përshtatshëm për histori të thjeshta, për figura etj.

Shprehja në fjali e përmbajtjes kuptimore të një serie fotografish

- Plotësimi pjesëve të një teksti të paradhënë

P.sh. gjetja e një mbylljeje për një histori

- Ushtrime formulimi lidhur me një situatë

Në fushën e fjalorit dhe të strukturave të fjalisë

- Përdorimi i modeleve të thjeshta të shkrimit sipas funksionit

P.sh. mbishkrimi i fletoreve dhe librave; adresave në kartolinat përshëndetëse; lista librash

- Përpunimi i përbashkët i një teksti

P.sh. për një ndodhi, fotografi

Hartimi i tekstit

Në fillim shkrimet e përpunuara në mënyrë të pavarur mund të përbëhen vetëm nga një fjalë, grup fjalësh apo një fjali e shkurtër. Në përgjithësi ato së pari zgjerohen dalëngadalë me dy a më shumë fjali të shkurtra (pak edhe nëpërmjet hartimit të përbashkët të teksteve). Në hartimin e teksteve – duke u nisur në zanafillë nga lidhja e fortë me unin e shkrimit fëminor – është për t'u synuar që të merren dalëngadalë parasysh një ose më shumë synime kryesore të shkrimit:

- të lihen të tjerët të bisedojnë ose të marrin pjesë (p.sh. shkrimi i përjetimeve personale, në mënyrë që të tjerët të mund t'i lexojnë)

- informimi i të tjerëve (p.sh. përmes lajmërimeve, përshkrimmeve të thjeshta)

- apelimi tek të tjerët (p.sh. përmes lutjeve, dëshirave, kërkesave dhe ftesave)

- mbajtja shënim (p.sh. letër dalluese, rregjistër)

Drejtshkrimi

Në punën mësimore duhet të synohet, që nxënësit deri në fundin të nivelit të 2-të shkollor

- zotërimin mundësisht të sigurtë të një fjalori të kufizuar të ushtruar hollësisht;
- të mund të përdorin disa strategji, për t'ia dalë mbanë në të shkruarin sipas normave;
- të kenë fituar disa njohuri thelbësore të shkrimit me shkronjë të madhe, të pikësimit dhe ndarjes së fjalës.

Motivimi

Zgjimi dhe përkrahja e përpjekjes për një të shkruar sipas normave

Përpunimi dhe përdorimi i sigurtë i një fjalori të kufizuar

- Zgjedhja e fjalorit  
Fjalë, kuptmi i të cilave tashmë është kapur, të përzgjidhen sipas kriterëve të mëposhtme: fjalor aktiv, shpeshësia, vlera si shembull duke marrë parasysh dhe ndërtimin e analogjive dhe të rregullave të mëvonshëm
- Copëtimi i fjalëve  
Copëtimi i fjalëve akustikisht, optikisht dhe sipas motorikës së të folurit  
Zbulimi i përputhjeve, përputhjeve të pjeshme dhe mospërputhjeve ndërmjet tingullit dhe shkrimit  
Konstatimi i mënyrës së njëjtë të shkrimit në fjalë të ndryshme (dyfishimet, mbaresat etj.)
- Të ushtruarit e fjalëve  
Kopimi dhe shkrimi i fjalëve, grupeve të fjalëve dhe fjalive të shkurtra  
Përdorimi i fjalorit të mësuar në kontekste të ndryshme gjuhësore

Arritja nga shkrimi u sigurtë i fjalëve në forma të tjera fjalësh d.m.th. e fjalëve të tjera (parimi i rrënjës; familje fjalësh)

Shembuj:

Straße - Straßen,

Baum – Bäume,

Stange – Stängel

kalt – kälter

gehen - geht

esen – isst  
farhren – mifahren – Fahrzeug  
Bahn, Autobahn, Eisenbahn

#### Veçoritë e drejtshkrimit:

- Shkrimi me shkronjë të madhe  
Kapja nga analogjitë e shumta,
  - që emrat në gjermanisht shkruhen me të madhe
  - që fjala e parë në fjali dhe fjala e parë në një titull shkruhen me të madhe
- Pikësimi  
Përdorimi i saktë i shenjave të pikësimit p.sh. i pikës, pikëpyetjes dhe pikëçuditëses në shembujt e kapshëm lehtë
- Ndarja  
Ndarja e fjalëve të përbëra të thjeshta në fjalë të veçanta  
Në rastet të thjeshta: ndarja e fjalëve sipas rrokjeve

#### Strategji përkrahëse në mësimin e drejtshkrimit:

- akustike dhe motorika e të folurit  
Të folurit e artikuluar qartë të mund të dallohet si ndihmë e mundshme për të shkruarin sipas normave, veçanërisht lidhur me gjatësinë e zanoreve për shkrimin e “ss” dhe “ß”  
Të folurit pa zë gjatë të shkruarit
- vizuale motorika e të shkruarit  
Ngulitja përmes të lexuarit dhe të shkruarit e shkrimeve sipas normave  
Shkrimi gjithnjë e më shumë i fjalëve nga imagjinata
- Përdorimi i dijeve të para të drejtshkrimit  
Përdorimi i gjykimeve elementare në rregullsinë e drejtshkrimit
- Ndihamat për drejtshkrimin  
T’i kërkojë mësuesit, prindërve dhe shokëve të klasës informacion  
Futja në përdorim e fjalorit; përdorimi i fjalorit dhe i dokumentave të tjera të shkruara

## Vrojtimi i gjuhës

Në punën mësimore duhet të synohet, që nxënësit deri në fund të nivelit të 2-të shkollor

- Të zhvillojnë interesat në marrëdhënien e vetëdijshme me gjuhën.

Gjykimi në gjuhë përmes zbulimit, krahasimit dhe vrojtimit

Në kuadrin e mësimin të të lexuarit të parë nxënësit mund të ndërgjegjësohen për shumë dukuri gjuhëore, p.sh. zërthimi i teksteve të shtypura dhe të shkruara në fjalë; shkronjat në pozicione të ndryshme në një fjalë

Krahasimi dhe vrojtimi i përsëritur i materialit të dukshëm gjuhësor që ndodhet para nesh

çon gjithnjë e më shumë në kuptimin e dukurive gjuhësore (në procese edhe në emërtimin e tyre)

Këtu mund të shtrohet dhe të përkrahet gjithashtu njohuria, se përmes kuptimit të ndryshuar në të shumtën e rasteve ndryshon dhe figura grafike dhe tingëllore e fjalës (Puppe – Puppen, Maus – Maeuschen)

Gjykimi në gjuhë përmes kontaktit në formë loje me elementët gjuhësorë

Ndërtimi i fjalëve të reja përmes heqjes, shtimit apo shkëmbimit të një shkronje apo të një tingulli

Fjalë të rimuara

Fjalë pa kuptim

Fjalë si njësi kuptimore

Ndërtimi dhe shndërrimi i fjalive

Plotësimi i fjalive të paplota përkatësisht i fjalive, ku mungojnë pjesë të ndryshme

Përdorimi i shenjave të pikësimit:

pikës, pikëpyetjes, pikëçuditëses

Pjesa e ligjeratës”emri”

Mbledhja dhe renditja e emrave nga bota e jetës së nxënësve (emra njerëzish, kafshësh, , bimësh, sendesh)

Kërkimi i emrave në fjali

Shumica e emrave mund t’i kategorizohen nyjeve shquese der, die ose das

Nocione që lidhen me gjuhën

Kuptimi i nocioneve “shkronjë, “fjalë”, “fjali” në përputhje me shëmbujt (jo përkufizim të tyre) dhe përdorimi i tyre në marrëdhënie me gjuhën

Niveli i 2-të fillestar

Të folurit

Si pika kyçe brenda fushave të veçanta të punës deri në fund të nivelit të katërt shkollor vlejné:

Të treguarit, të informuarit, të dëgjuarit

- vënia në përdorim dalëngadalë në mënyrë të vetëdijshme e formave gjuhësore të të shprehurit
- kuptimi i gjëndjes së të tjerëve, mendimeve dhe rrethnave përmes dëgjimit të vëmëndshëm;

Të folurit lidhur me një situatë

- Vlerësimi dhe përballimi i përshtatshëm nga ana gjuhësore i situatave të llojeve të ndryshme;

Biseda

- zhvillimi relativisht i pavarur i bisedave lidhur me një partner, rrethanë dhe problem në forma të ndryshme;
- formulimi, argumentimi dhe zbatimi i rregullave të bisedës;
- njohja e teknikave të thjeshta të bisedës dhe përdorimi në përputhje me situatën;
- përdorimi i formave gjuhësore dhe të të folurit të mësuara në shkollë;

Ushtrimi i gjuhës (zgjerimi i aftësisë gjuhësore)

- të kenë të disponueshëm një fjalor bazë të shtjelluar nga ana kuptimore;
- të kenë fituar një siguri gjithnjë e më të madhe në përdorimin e gjuhës standarte;

Niveli i 3-të shkollor

Të treguarit, të informuarit, të dëgjuarit

Të treguarit në mënyrë interesante dhe të qartë, të tjerët bisedojnë  
Të treguarit për ndodhi , përjetime personale në një rend të saktë kohor

Marrja parasysh gjatë të treguarit e hollësive të rëndësishme  
Përmes të treguarit të tjerët të bisedojnë  
Të treguari të tjerëve i historive të shkurtra të lexuara ose të dëgjuara  
Tregimi i historive të imagjinuara (për foto, histori, fjalë, pantonima etj.

Informimi i të tjerëve  
Paraqitja mundësisht me saktësi nga ana gjuhësore e rrethanave dhe ecurive të veprimeve të thjeshta  
Rrrefimi për të tjerët i ndjenjave, mendimeve dhe dëshirave personale  
Përshkrimi i tipareve dalluese të objekteve , kafshëve dhe njerëzve

Dëgjimi i vemendshëm  
Dëgjimi për një kohë të gjatë dhe me vemendje i folësve të tjerë  
Kuptimi dhe ritregimi i thelbësorës  
Pozicioni ndaj asaj që është dëgjuar

Të folurit lidhur me një situatë të caktuar:

Përballimi nga ana gjuhësore në mënyrë graduale dhe të sigurtë i situatave të ndryshme të procesit të të folurit  
Përballimi nga ana gjuhësore i situatave reale të veprimit përkatësisht të situatave të prezantuara me role si p.sh.:

- hyrja në kontakt me dikë
- përdorimi i saktë i shprehjeve të ngushëllimit, urimit, kërkesave
- dhënia të drejtë dikujt, njohja e mendimit të tjetrit
- arsyetimi i mendimit personal

Biseda:

Shkollimi i mëtejshëm i të dëgjuarit, të dëgjuarit të njëri-tjetrit dhe të kuptuarit

P.sh. lojra të ndryshme komunikative; dallimi i thelbësorës nga jothelbësorja; përmbledhja e rezultateve të rëndësishme të një bisede të shkurtër

## Zgjerimi i rregullave dhe teknikave të bisedës

P.sh. qëndrimi në temë

Arsyetimi i pohimeve personale

Mospranimi i gjithshkaje pa pyetur

Marrja pjesë përmes pyetjeve kthyesë, dhënia të drejtë, refuzimi

Përpjekja e sqarimit të rrethanave dhe problemeve (përmes pyetjeve, gjykimit të kontributit në bisedë)

Përshtatja me pjesëmarrësit në bisedë dhe rolin e tyre përkatës

## Zotërimi i formave të thjeshtat të bisedave

Biseda me partnerin, në grup dhe në rreth mbi tema dhe probleme pune nga fusha e interesave dhe eksperiencave të fëmijëve ose nga ndeshja me çështje të fushave të ndryshme të të mësuarit

Si edhe në nivelin e 1-rë fillestar, nga situata të caktuara mund të dalin ose të nxiten me qëllim shkaqe spontane për bisedë.

## Ushtrimi i gjuhës (zgjerimi i aftësisë gjuhësore):

### Zgjerimi dhe diferencimi i fjalorit

Diskutimi dhe përshkrimi i objekteve dhe fotove

Paraqitja me anë të gjuhës i vrojttimeve dhe proceseve

Provimi i mundësive të ndërtimit të fjalëve

Dallimi i kuptimit të fjalëve përmes renditjes, krahasimit dhe përdorimit

### Ushtrimi dhe zgjerimi i modeleve të fjalive të gjuhës standarte

Përdorimi i prafjalëve me rasat e sakta

Të ushtruarit e modeleve të fjalive me një shkallë vështirësie në rritje, për të parandaluar format e gabuara ( seri fjalish dhe periudha )

### Ushtrimi i të folurit (të folurit e qartë):

Të folurit e pasur me shprehje

Ndërtimi i thënieve personale me shprehje të pasura

Përkrahja e shprehjeve gjuhësore përmes mimikës dhe gjesteve

Provimi i mundësive të ndryshme shprehëse në komunikimin gjuhësor në lidhje me situata të caktuara (situatë e prezantuar me role)

Të folurit qartë

Ushtrime për të mësuarin e artikulimit:: Artikulimi i vetëdijshëm i fjalëve dhe teksteve gjatë të folurit (lojra për shkathtësimin e të folurit, fjalë ngatërruese, tekste humoristike dhe të këtilla si këto)

Krijimi i sigurisë në ndërtimin e tingullit dhe ushtrime për dallimin e tingujve

Të folurit e teksteve duke i riprodhuar dhe duke i transformuar  
Shprehja e gjëndjeve të ndryshme emocionale nëpërmjet mënyrave të ndryshme të inetrpretimit të teksteve ( duke shprehur gëzim, keqardhja etj.)

Të folurit

Niveli i katërt shkollor

Të treguarit, të informuarit, të dëgjuarit:

Të treguarit me një synim të vetëdijshëm ndërtimi, të tjerët bisedojnë  
Vënia graduale në jetë e qëllimit të ndërtimit të tregimit (ndërtimi i pikës kulmore, shkaktimi i tensionit, zgjimi i keqardhjes etj. si këëto)

Informimi i të tjerëve

Përshkrimi me vend i tipareve thelbësore të objekteve, kafshëve dhe personave

Dhënia e mëtejshme e informacioneve për çështje të caktuara (p.sh tregimi i konteksteve reale me ndihmën e teksteve, figurave, pikturave etj.)

Përmbledhja e rezultateve të punës

Transmetimi tek të tjerët i ndjenjave, mendimeve dhe dëshirave vetjake

Të dëgjuarit me vëmëndje

Dëgjimi me vëmëndje për një kohë të gjatë i burimeve gjuhësore të llojeve nga më të ndryshmet (duke përfshirë dhe mediat)

Kuptimi i thelbësorës dhe mundësisht ritregimi i përpiktë i saj

Pozicionimi ndaj asaj që është dëgjuar

T ë konstatohet përse pëlqehet një prezantim, përse një tregim duket gazmor, i trishtuar, tërheqës

Të folurit lidhur me një situatë të caktuar:

Përballimi nga ana gjuhësore në mënyrë graduale dhe të sigurtë i situatave të ndryshme në procesin e të folurit

Përballimi nga ana gjuhësore i situatave reale të veprimit përkatësisht të situatave të prezantuara me role si p.sh.:

- hyrja në kontakt me dikë
- gjallërimi, urimi, vendosja e saktë, ankimi
- dhënia të drejtë dikujt, njohja e mendimit të tjetrit
- arsyetimi dhe përfaqësimi i mendimit personal

Biseda:

Shkollimi i mëtejshëm i të dëgjuarit, të dëgjuarit të njeri – tjetrit dhe të kuptuarit

P.sh. nëprmet lojrave të ndryshme komunikative; përmbledhja e rezultateve thelbësore të një bisede; përzgjedhja dhe vlerësimi nën këndvështrime të caktuara i marrjes pjesë në bisedë.

Elementë shprehës të rëndësishëm për bisedën

P.sh. hyrja në bisedë, nisja e saj, kalimi në temë, vazhdimi i saj, përmbledhja e saj e të ngjashme si këto.

Zgjerimi i rregullave dhe teknikave të bisedës

Mbrojtja e mendimit personal ( mosdorëzimi i menjëhershëm ).

Ndryshimi i mendimit të vetjak, kur nxënësi është i bindur për këtë.

Synimi i sqarimit të rrethanave dhe problemeve (p.sh. përmes hamendjeve, pyetjeve, argumentave, vërtetimeve, kundërshtimeve, informatave ).

Zotërimi i formave të ndryshme të bisedës

Zhvillimi gjithashtu i bisedave më të gjata dyshe, në grup dhe në rreth përkatësisht diskutime mbi tema, probleme dhe çështje nga fusha të interesave dhe eksperiencave të fëmijëve ose nga përballja e temave në disiplina të ndryshme të të mësuarit

Të folurit me njëri-tjetrin mbi ecurinë e bisedës ( p.sh. në lidhje me një pjesë të dëgjuar në manjetofon).

Rastet për biseda mund të shfaqen spontanisht ose mund të nxiten nga mësuesi.

Te ushtruarit e gjuhës ( zgjerimi i aftësisë gjuhësore )

Zgjerimi dhe diferencimi i fjalorit

Paraqitja me vend, e qartë, me logjikë dhe faktike e proceseve dhe zhvillimeve të veprimeve.

Provimi i mundësive të ndryshme të formimit të fjalëve.

Dallimi i kuptimit të fjalës përmes krahasimit dhe kufizimit.

Të ushtruarit e përdorimit të pjesëve të veçanta të ligjëratës duke ju përmbajtur gjuhës standarte:

Perfeksionimi i përdorimit sipas normave gjuhësore i foljes, emrit dhe mbiemrit.

Korrigjimi i formave të gabuara.

Të ushtruarit dhe zgjerimi i modeleve të fjalisë sipas gjuhës standarte letrare  
Perfeksionimi i përdorimit të modeleve të fjalive me strukturë të komplikuar për të parandaluar format e gabuara.

Të ushtruarit e të folurit ( të folurit e qartë ):

Të folurit e pasur me shprehje

Ushtrime për përdorimin e sigurtë të mjeteve të ndryshme gjuhësore për një të folur të pasur ( lartësia e tingullit, artikulimi, tempi, pauzat, mimika, gjestet ).

Formimi i situatave dialoguese të pasura me shprehi.

Të folurit e qartë

Kërkesa të larta në mësimin e artikulimit ( gjuhe pëshpëritëse, distanca më të mëdha etj.)

Ushtrime për teknikën e të folurit: Të folurit shpejt dhe qartë të grupëfjalëve dhe teksteve .

Perfeksionimi në formimin e tingullit dhe ushtrime për dallimin e tingujve.

Të folurit sipas një teksti model ose duke e shndërruar këtë tekst

Ndërtimi i formave të reja fonetike përmes ndryshimit në formë loje të teksteve si edhe shprehja e gjendjeve të ndryshme shpirtërore dhe tipareve të ndryshme të karakterit përmes të folurit në forma të ndryshme të teksteve.

Të lexuarit

Në punën mësimore duhet synuar, që nxënësit deri në fund të nivelit të katërt shkollor:

- ta orientojnë të lexuarin e tyre nga interesat personale;
- të mund të lexojnë dhe zbërthejnë në mënyrë të pavarur tekste të përshtatshme për moshën e tyre;
- të mund të dallojnë përmes konfrontimit me tekstet synimet, ndikimet e tyre e të këtilla si këto;
- të mund të lexojnë me zë tekste të parapërgatitura duke dhënë qartë kuptimin e tyre.

Niveli i tretë shkollor

Mbështetja dhe përkrahja e gadishmërisë dhe interesave individuale për të lexuar.

Këshillimi mundësisht i shpeshtë për tekste aktuale dhe në përputhje me moshën dhe ofrimi i teksteve të shumëllojshme të përshtatshme për moshën e nxënësit ( nga biblioteka e klasës dhe e shkollës ).

Nxitja për gjetjen në mënyrë të pavarur të teksteve nga vetë nxënësit ( vizitë në bibliotekë, shkëmbim librash ).

Të mësuarit e faktit që nga tekstet mund të merret një mesazh

- nga tekstet letrare

Përjetimi dhe dallimi i ndërvarësive të veprimeve në përralla, gojëdhëna, tregime, histori për ambjentin etj; ridhënia e saktë e ecurisë së veprimeve të thjeshta ( p.sh. të treguarit, të luajturit ); kuptimi i efekteve.

Të folurit bashkarisht rreth teksteve dhe ndikimeve të ndryshme të tyre.

Shprehja dhe arsyetimi i mendimit personal rreth teksteve, vazhdimi i teksteve plot fantazi

- nga tekstet me përdorim të gjerë

Përdorimi i figurave dhe shkrimeve poshtë tyre si informacion shtesë.

Përdorimi si burime informacioni i pasqyrës së lëndës ( së një libri ), i përshkrimeve të shkurtra etj.

Marrja e informacioneve nga enciklopedi, fjalorë.

Zbërthimi i përmbajtjes së informacionit nga mbishkrimet, titujt e librave etj.

Rritja e aftësisë për të lexuar

Të lexuarit me një vështrim të përgjithshëm në hapa kuptimorë gjithnjë e më të mëdhenj

Të lexuarit e teksteve në rradhitje të ndryshme hapsinore (p.sh. i tekste në formën e piramidës)

Të lexuarit e teksteve pa hapësira ndërmjet fjalëve dhe pa shenja pikësimi

Të lexuarit e teksteve me shkrime të llojeve të ndryshme (p.sh. format e ndryshme të shkrimit në bllok, e shkrimit të shtypit, shkrimit të shtypit)

Ushtrime të shumëllojshme për një shqiptim të mirë

Të lexuarit e teksteve të thjeshta duke marrë parasysh rrjedhshmërisë në të lexuar.

Të lexuarit e teksteve të thjeshta në një kohë gjithmonë e më të shpejtë.

Parapërgatitja dhe ushtrimi i të lexuarit me zë dhe recitimit në përshtatje me tekstin.

Të ushtruarit e shumëllojshëm të leximit dhe recitimit në përputhje me kuptimin

- leximi dhe recitimi i rimave për fëmijë, poezive, historive etj. duke pasur parasysh në mënyrë të vecantë strukturën e tingullit dhe pauzat në të folur.
- Të mësuarit përmendësh dhe të recituarit e poezive.

Të lexuarit

Niveli i katërt shkollor

Përkrahja dhe forcimi i shprehive të mira të leximit, zgjerimi dhe formimi i interesave individuale të të lexuarit.

Nxitja mundësisht e shpeshtë për konfrontimin me tekste aktuale dhe të përshtatshme për moshën.

Ofrimi i teksteve të shumëllojshme dhe të përshtatshme për moshën (nga biblioteka e klasës, e shkollës etj.).

Përkrahja e përzgjedhjes së teksteve në mënyrë të pavarur ( vizitë në bibliotekë, shkëmbim librash etj.)

Zgjerimi i aftësisë për të zbërthyer një tekst dhe aftësisë për ta kuptuar atë

- Tekste letrare

Leximi i përrallave, gojëdhanave, fabulave, historive për ambientin, tregimeve, teksteve në formë dialogësh etj., kjo për të biseduar, për të bashkëndierë dhe për të nxitur etj.

Ridhënia e ecurisë së një veprimi, të një ngjarjeje nëpërmjet tregimit, nëpërmjet paraqitjes në formë loje ose me pantonima

- Tekste të përdorimit të gjerë

Leximi i librave profesionalë, enciklopedive, teksteve të shkurtra të përdorimit të përditshëm (p.sh.rregullave të lojës, udhëzuesve, recetave të gatimit) për t'u informuar.

Vlerësimi dhe përdorimi i informacioneve

- konfrontimi në mënyrë të pavarur me tekste të llojeve të ndryshme

Vënia përballë njëri-tjetrit e teksteve të ndryshme me të njëjtën temë, të kërkuarit për dallime.

Njohja dhe komentimi i qëllimeve në një tekst ( p.sh. në një tekst reklame)

Mbajtja e një qëndrimi ndaj teksteve në formë të thjeshtë.

Rritja e aftësisë së të lexuarit

Leximi me një vështrim të përgjithshëm në hapa kuptimorë gjithnjë e më të mëdhenj

Leximi i teksteve me renditje hapsinore të ndryshme

Të lexuarit e teksteve me shkrime të llojeve dhe madhësive të ndryshme (forma të ndryshme të përziera me shkrimin antik, shkrimin latin)

Të lexuarit me saktësi të tingullit dhe fjalës

Leximi i teksteve të thjeshta duke rritur në mënyrë të vazhdueshme rrjedhshmërinë në lexim

Leximi i teksteve të thjeshta me një temp gjithnjë e më të shpejtë.

Parapërgatitja dhe ushtrimi i të lexuarit me zë si edhe i të recituarit sipas llojit të tekstit.

Ushtrimi i shumëllojshëm i të lexuarit me zë dhe i të recituarit duke ndërtuar tekstin në përputhje me kuptimin e tij.

- leximi dhe recitimi i poezive, teksteve në formë dialogu, historive etj. duke marrë parasysh vecanëritsht paizat në të folur dhe ndërtimin e shprehjeve.

- Mësimi përmendësh dhe recitimi i poezive.

Hartimi i teksteve

Si pika kyce deri në fund të nivelit të katërt shkollor vlejné:

- Tek nxënësit të jetë zhvilluar një ndjenjë kënaqësie në hartimin e teksteve;
- Shkrimi i përjetimeve , vrojttimeve, dialogjeve, sajimeve vetjake dhe të ngjashme si këto;
- Shkrimi i lajmërimeve, kërkesave, dëshirave, këshillave, udhëzimeve, detyrave e të ngjashme si këto;
- Shkrimi me fjali të plota ose me fjalë kryesore për persona, kafshë, objekte, procese veprimi dhe rrethana;
- Dhënia me shkrim e përmbajtjes së figurave të vecanta ose serive të figurave, si edhe plotësimi dhe ndryshimi i teksteve.
- Shkrimi i letrave, kartolinave përshëndetëse dhe të ngjashme si këto për raste të ndryshme.
- Ridhënia me shkrim me fjalët e tyre ( me fjali të plota ose me fjalë kryesore ) e asaj që kanë lexuar, dëgjuar, parë, ndjerë dhe menduar.

### Niveli i tretë shkollor

#### Ushtrime shoqëruese mbi hartimin e teksteve:

- Dallimi i të rëndësishmes nga ajo më pak e rëndësishme përkatësisht e asaj që s'ka rëndësi.

P.sh. gjetja e titujve të përshtatshëm për figura dhe tekste

- Renditja e mendimeve në mënyrë që të dallohen dhe gjehen mundësitë e ndërtimit të një teksti.

P.sh. renditja dhe plotësimi i figurave në seri dhe të teksteve me pjesë. Dallimi dhe formulimi i fillimit, pikës kulmore dhe mbylljes së teksteve.

- Shprehja e mendimeve mundësisht në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe sipas rradhës.

Formulimi gjithmonë lidhur me një situatë dhe në fushën e fjalorit dhe të strukturave të fjalisë: Fjalët e duhura; kërkesat, thirrjet, pyetjet; format se si i drejtohem një personi në një letër, hyrja dhe mbyllja e saj. Përdorimi i ligjëratës së drejtë

- Përpunimi bashkarisht i teksteve që janë të bazuara në eksperiencën të ndryshme

Përpunimi në grupe të vogla ose me klasën i teksteve mbi një përjetim të përbashkët, mbi një figurë dhe të ngjashme si këto.

- Përdorimi i modeleve të thjeshta të të shkruarit sipas funksionit të tyre.  
Plotësimi i formularëve dhe tabelave të thjeshta dhe të ngjashme si këto; shkrimi i adresave, listave etj.

#### Hartimi i tekstit:

- para së gjithash për t'i lejuar të tjerëve të bisedojnë ose të marrin pjesë.  
P.sh. nëpërmjet përjetimeve, ëndrrave vetjake; nëpërmjet historive të thjeshta mbi figura të dhëna ose të krijuara vetë, mbi fjalë ngacmuese mbi bërthamën e një tregimi; nëpërmjet vazhdimit të tregimit të historive të filluara; nëpërmjet teksteve me shprehje gjuhësore të caktuara, nëpërmjet historive të sajuara, kartolinave, letrave dhe vargjeve gazmore.

- Para së gjithash për të informuar të tjerët.  
P.sh. nëpërmjet përshkrimeve të thjeshta, nëpërmjet udhëzimeve, ftesave, lajmërimeve; planifikimit të detyrave, lajmërimeve për humbjen e dikujt ose dickaje; nëpërmjet letrave dhe kartolinave.

- Para së gjithash për të apeluar tek të tjerët ( eventualisht edhe tek vetja)  
P.sh. nëpërmjet ftesave, teksteve të thjeshta të reklamave ( në formën e prospektit, pllakatit, tabelës etj.), urdhëesave dhe ndalesave.

- Para së gjithash për të shënuar dicka për vete  
P.sh. lajmërimi ( telefonike ), lista e mallrave që do të blihen në pazar, receta gatimesh, tekste të shkurtra profesional, tekste këngësh.

#### Hartimi i teksteve

#### Niveli i katërt shkollor

#### Ushtrime shoqëruese për hartimin e teksteve:

- Dallimi i të rëndësishmes nga ajo më pak e rëndësishme përkatësisht nga ajo që është pa rëndësi

P.sh. Nënvizimi i asaj që është e rëndësishme në tekste; shkrimi i fjalive ose fjalëve kyçe mbi atë që është lexuar ose dëgjuar.

- Renditja e mendimeve dhe me këtë dallimi dhe gjetja e mundësive të ndërtimit të tekstit.

P.sh. renditja dhe plotësimi i serive të figurave dhe pjesëve të teksteve të dhëna; dallimi dhe formulimi i hyrjes, pikës kulmore dhe mbylljes së një teksti; ndërgjegjësimi për rradhitjen dhe mënyrën e lidhjes së fjalive dhe marrja parasysh e tyre në shkrimin vetjak.

- Paraqitja e mendimeve kryesisht në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe mundësisht sipas një rradhe të saktë.

P.sh. paraqitja gjirhnjë e më e përshtatshme nga ana gjuhësore e sendeve, veprimeve, cilësive, rrethanave, situatave të ndryshme; gjetja e fjalëve të përshtatshme, formulimi i arsytimeve, zgjedhja e kohës së përshtatshme dhe vënia në përdorim e orientuar e ligjeratës së drejtë.

- Përpunimi bashkarisht i teksteve të bazuara në eksperiencë të ndryshme  
P.sh.përpunimi në grupe të vogla ose në bisedë me klasën i teksteve mbi një përjetim të përbashkët, mbi figura ose mbi një temë që ka të bëjë me çështje të të mësuarit etj.

- Përdorimi i modeleve të të shkruarit në përputhje me funksionin e tyre.  
P.sh. plotësimi i formularëve, mandateve të pagesave etj.; shkrimi i listave, inventarëve etj.; përgatitja e një skedari të përshtatshëm për bibliotekën e klasës.

### Hartimi teksteve

Nxënësit duhet të dallojnë në mënyrë gjithmonë e më të ndërgjegjshme, se mënyra e formulimit të një teksti varet kryesisht nga qëllimi i të shkruarit dhe nga ajo, se kujt i drejtohet.

- para së gjithash, për t'i lejuar të tjerët të bisedojnë ose të marrin pjesë  
P.sh. nëpërmjet të treguarit të përjetimeve vetjake, ëndrrave, historive mbi figura të dhëna më përpara ose të krijuara vetë, mbi fjalë ngacmuese, mbi bërthamën e një tregimi, fillimin dhe mbylljen e fragmenteve të tregimeve; teksteve me shprehje gjuhësore të gatshme, historive të sajuara, kolazhe fjalësh dhe fjalish gazmore, përmes një gjuhe sekrete, barsaletave, dialogjeve, letrave, kartolinave.

- para së gjithash për të informuar të tjerët  
P.sh. nëpërmjet përshkrimit të personave, kafshëve, objekteve, ecurive të veprimeve dhe rrethanave; nëpërmjet tregimit me fjalët e tyre të teksteve të

thjeshta (edhe duke ndryshuar këndvështrimet); nëpërmjet manualeve të përdorimit dhe të punës me dorë, ftesave, lajmërimeve për shitje, shkëmbime dhe humbjen e diçkaje; nëpërmjet letrave dhe kartolinave për raste të ndryshme.

- para së gjithash për t'iu bërë apel të tjerëve (eventualisht edhe vetes) p.sh. nëpërmjet rregullave të lojës, ftesave, programeve, teksteve të reklamave (në formën e prospektit, pllakatit, tabelës dhe të ngjshme si këto) lajmërimeve të ndryshme; fletë palosjeve

- parpa së gjithash për të shënuar diçka për vete  
P.sh. lajmërimet dhe vërejtje të të gjitha llojeve, receta gatimi; dije të vlefshme, tekste tematike, tekste këngësh; përjetime në një ditë.

### Drejtshkrimi

Në punën mësimore duhet synuar, që nënësit deri në fund të nivelit të katërt shkollor

- të kenë ushtruar në mënyrë rrënjësore dhe ta zotërojnë mundësisht në mënyrë të sigurtë një fjalor të përdorimit të përgjithshëm, por të kufizuar në shkrim;
- të njohin disa nga problemet dhe fenomenet thelbësore të drejtshkrimit, p.sh. rastet më të përdorshme të shkronjës së madhe, pikësimin si edhe përcaktimin e gjatësisë dhe shkurtësisë së zanores;
- të mund të përdorin në mënyrë gjithnjë e më të pavarur strategjitë e të shkruarit;
- të ndërgjegjësohen për rregullsitë dhe nga kjo të formulohen dhe të përdoren rregulla të përpunuara thjeshtë.

### Niveli i 3-të shkollor

#### Motivimi

Përpjekja për të ruajtur dhe përforcuar një të shkruar sipas të gjitha normave gjuhësore.

Përpunimi dhe sigurimi i një fjalori të kufizuar

- Përzgjedhja e fjalorit

Përzgjedhja sipas kritereve të mëposhtme e fjalëve, domethënia e së cilave është bërë tashmë e qartë: fjalori aktiv, shpeshësia, vlera e veçantë duke marrë parasysh këtu edhe ndërtimin e rregullave dhe analogjive.

- Ndarja e fjalëve

Ndarja akustike, optike dhe sipas kriterit motorik të të folurit e fjalëve.  
Zbulimi i përputhjeve, përputhjeve të pjesshme dhe mospërputhjeve në tingëllim dhe në të shkruar.  
Konstatimi i mënyrës së njëjtë të të shkruarit të fjalëve të ndryshme.

- Përforcimi i procesit të të shkruarit të fjalëve

Të shkruarit me një vetëdije gjithnjë e më të plotë të fjalëve, togfjalëshave dhe fjalive.  
Përdirimi i një fjalori të përpunuar në konekste të ndryshme gjuhësore.

Përdorimi i fjalëve të sigurta drejtshkrimore për të shkruarin e formave dhe fjalëve të tjera

Bashkimet e fjalëve  
Prejardhjet e fjalëve  
Analogjitë  
Familjet e thjeshta të fjalëve; rrënja e fjalës si ndihmë

Vecantitë e drejtshkrimit:

- Shkrimi me shkronjë të madhe

Përforcimi i procesit të të shkruarit me shkronjë të madhe të emrave, të fjalës së parë në fjali dhe të fjalës së parë të një titulli.  
Shkrimi me shkronjë të madhe i përemrit vetor të politesës “Sie”, te përemrit pronor korrespondues “Ihr” si edhe formave të tjera të tyre.

- Përcaktimi i gjatësisë së zanoreve

Mbledhja dhe ushtrimi i fjalëve me një gjatësi të përcaktuar ose jo të zanoreve (p.sh. Saal; nahm; kam- jo krahasime!)

- Percaktimi i shkurtësisë së zanoreve

Mbledhja dhe ushtrimi i fjalëve me një shkurtësi të përcaktuar ose jo të zanoreve.

- Shpeshësia e bashkëtingëlloreve që ndjekin njëra-tjetrën

Ushtrimi i fjalëve tek të cilat shfaqet fenomeni i shpeshësisë së bashkëtingëlloreve që ndjekin njëra-tjetrën (p.sh. pflügen; pflücken; empfangen; Schlusssatz; Krepppapier)

- Ndarja

Ndarja e fjalëve të përbëra në fjalë më të vogla përbërëse

Ndarja e fjalëve të shkruara sipas rrokjeve të të folurit (p.sh. Ap=fel, Ëes=pen, ras=ten)

“ck” nuk mund të ndahen (p.sh. Zu=cker)

Shenjat e pikësimit

Përdorimi i sigurtë në situata të thjeshta i shenjave të pikësimit që vendosen në fund të fjalisë si pika, pikëpyetja, pikëcuditsja.

Situata të thjeshta të vendosjes së presjes, p.sh. tek numeracionet

Përdorimi i shenjave të pikësimit në rastin më të thjeshtë të ligjëratës së drejtë (p.sh. Eva fragt:, ....?)

Ndihma për drejtshkrimin

Vënia në përdorim gjithnjë e më shumë e dijeve të fituara për drejtshkrimin

Rradhitja e fjalëve në mënyrë alfabetike, edhe pas shkronjës së dytë.

Ushtrime për përdorimin e fjalorit.

Mësime për përdorimin e fjalorit si një mjet i sigurtë ndihmës për drejtshkrimin.

Niveli i katërt shkollor

Motivimi

Perpjekja për të ruajtur dhe forcuar një të shkruar korrekt sipas normave gjuhësore.

- Përzgjedhja e fjalorit

Përzgjedhja sipas kriterëve të mëposhtme e fjalëve, domethënia e së cilave është kuptuar tashmë: fjalori aktiv, shpeshësia, vlera e vecantë duke marrë parasysh këtu edhe ndërtimin e rregullave dhe analogjive.

- Ndarja e fjalëve

Ndarja akustike, optike dhe sipas kriterit motorik të të folurit e fjalëve. Zbulimi i përputhjeve, përputhjeve të pjesshme dhe mospërputhjeve në tingëllim dhe në të shkruar.

Konstatimi i mënyrës së njëjtë të të shkruarit të fjalëve të ndryshme.

- Përforcimi i procesit të të shkruarit të fjalëve, Përdorimi i vetëdijshëm i strategjive të të shkruarit

Të shkruarit me një vetëdije gjithnjë e më të plotë të fjalëve, togfjalëshave dhe fjalive, këtu dhe vënia në jetë e dijeve të fituara mbi rregullat

Përdorimi i fjalëve të sigurta drejtshkrimore për të shkruarin e formave dhe fjalëve të tjera

Bashkimet e fjalëve

Prejardhjet e fjalëve

Analogjitë

Familjet e thjeshta të fjalëve; rrënja e fjalës si ndihmë

Veçanti të drejtshkrimit

- Shkrimi me shkronjë të madhe

I përemrit vetor të politesës “Sie”, i përemrit pronor përkatës “Ihr” si edhe formave të tjera të tyre.

Fjala e parë në ligjëratë.

Folje të emëruara në situata të thjeshta ( das Lesen, beim Schreiben etj. )

Mbiemra të emëruar në situata të thjeshta (etëas Neues, alles Liebe und Gute )

- Përcaktimi i gjatësisë së zanoreve

Sigurimi nga ana drejtshkrimore i fjalëve me gjatësi të përcaktuar ose jo të zanoreve

Njohja e formave që përcaktojnë gjatësinë e zanoreve dhe përdorimi gjithnjë e më i drejtë i tyre ( dy zanore të njëjta, “ie”, “h” që tregon zgjatjen e zanores pritëse, “ß” ).

- Përcaktimi i shkurtësisë së zanoreve

Sigurimi nga ana drejtshkrimore i fjalëve me shkurtësi të përcaktuar ose jo të zanoreve.

Njohja e formave që përcaktojnë shkurtësinë e zanoreve dhe përdorimi gjithnjë e më i drejtë i tyre (dy bashkëtingëllore të njëjta, “tz”, ”ck”).

- Bashkëtingëlloret që ndjekin njëra-tjetrën

Ushtrimi i fjalëve tek të cilat shfaqet fenomeni i shpeshtësisë së bashkëtingëlloreve që ndjekin njëra-tjetrën (p.sh. “Arzt”, “schnell” ).

- Veçimi

Sigurimi i veçimit të fjalëve të fjalorit të përdorur në të shkruar ( p.sh. parashtesat, pjesët përbërëse të një fjale).

- Shenjat e pikësimit

Shenjat e pikësimit që përdoren në forma të thjeshta të ligjëratës ( p.sh. ....!, rief Markus.)

Ndihma për drejtëshkrimin

Përdorimi i vetëdijshëm i dijeve gjuhësore të fituara.

Rradhitja alfabetike e fjalëve, edhe sipas shkronjës së tretë (p.sh. Maler, Mann, Maus ) dhe sipas shkronjës së katërt (p.sh. schauen, schief, schreiben)

Ushtrime për përfitimin e një teknike mundësisht të shpejtë të shfletimit në fjalor për gjetjen e një fjale.

Përdorimi i fjalorit është mirë të mundësohet si gjatë punëve me shkrim, gjatë korigjimit të një diktimi ashtu edhe në detyrat e klasës.

### Vrojtimi gjuhësor

Në punën mësimore duhet synuar që nxënësit deri në fund të nivelit të katërt shkollor

- të jenë në gjendje të gjejnë gjymtyrët e fjalisë nëpërmjet provës së zhvendosjes së tyre
- të mund të dallojnë pjesët e ligjëratës dhe të mund t'i përcaktojnë ato me terminologjinë e saktë në gjermanisht
- të kenë fituar gjykimet e para në lidhje me fjalëformimin dhe kuptimin leksikor të fjalës

### Niveli i tretë shkollor

Vrojtimet e para në lidhje me funksionin dhe ndërtimin e fjalisë:

- Fjalitë si njësi e kuptimshme

Plotësimi me kuptim i fragmenteve të ndryshme të një fjalie

Vendosja në rregull e fjalive të pakuptimta

Ndryshimi disi i kuptimit të fjalisë nëpërmjet theksimit të fjalëve të ndryshme

- Dallimi i llojeve të ndryshme të fjalive

Dallimi i fjalive duke u nisur nga funksioni i tyre; pohore, pyetëse, thirrëse (vënia në provë në situata konkrete).

Thënia e fjalisë duke ruajtur të njëjtin rend fjalësh por duke i dhënë intonacione të ndryshme.

Përdorimi i shenjave përkatëse të pikësimit, të cilat qëndrojnë në fund të fjalisë.

- Njohja e gjymtyrëve të fjalisë si elementë të pazhvendosshëm

Bërja provë e zhvendosjes dhe demonstrimi i ndryshimeve në kuptim dhe efekt (fjalitë të “coptuara”).

Njohja e pjesëve më të rëndësishme të ligjëratës:

- Foljet si fjalë që emërtojnë veprime, ndodhi dhe gjendje

P.sh. emërtimi dhe zhvillimi i veprimeve.

Konstatimi i veprimeve në fusha të ndryshme.

Orientimi në kohët e ndryshme të foljes (në të tashmen, në të shkuarat dhe në të ardhmet ) mundësisht kjo në situata të natyrshme.

- Emrat si fjalë që emërtojnë njerëz, kafshë, bimë, mendime dhe përfytyrime

Bashkërenditja e grupeve të fjalëve që i përkasin fushave të ndryshme ( emërtimi i kafshëve, i bimëve, i sendeve ).

Përcaktimi me emra i fenomeneve abstrakte, p.sh. gëzim, frikë, fat.

Dallimi dhe rradhitja e emrave sipas kategorisë së numrit (njëjës, shumës ).

Vendosja e emrave në shumës.

Vendosja e emrave në njëjës.

- Nyja si një shoqëruese e mundshme e emrit

Rradhitja e emrave sipas nyjes.

- Mbiemrat, si fjalë që shërbejnë për emërtimin e tipareve

Mbiemrat si mjet për përshkrimin e saktë të tipareve të frymorëve dhe sendeve.

Kërkimi i mbiemrave të përshtatshëm nga ana kuptimore për emra të mdryshëm.

Një vështrim mbi fjalëformimin dhe kuptimin leksikor të fjalës:

- Bashkimi i fjalëve

Formimi i bashkimeve të thjeshta me emra.

Gjetja e një përcaktimi të saktë i arritur nga bashkimi i emrave ( p.sh. Tiergarten=kopësht zoologjik; hellgelb=ngjyrë veje e celet; fingerbreit=e gjerë sa një gisht ).

- Emrat përmbledhës

Përfshirja e personave, gjellëve, bimëve, kafshëve, sendeve etj. nëpërmjet emrave përmbledhës.

- Familjet e fjalëve

Grumbullimi i fjalëve me rrënjë të njëjtë dhe analizimi i kuptimit të tyre.

Vrojtimi gjuhësor

Niveli i katërt gjuhësor

Fitimi i gjykimeve në lidhje me funksionin dhe ndërtimin e fjalive

- Vendosja e foljeve në lloje të ndryshme fjalish

Përdorimi si lojë i gjymtyrëve të fjalisë.

Zbulimi se në ç'pozicion qëndron folja në lloje të ndryshme fjalish.

- Metoda për gjetjen e gjymtyrëve të fjalisë ( prova e zhvendosjes, e zëvendësimit, e mënjanimet dhe e zgjerimit ).

Studimi i fjalisë me ndihmën e provës së zhvendosjes.

Ndryshimi i informacionit nëpërmjet shkëmbimit të një gjymtyre ose nëpërmjet zhvendosjes.

Shkurtimi i fjalive.

Zgjerimi me kundrinorë i fjalive të shkurtra dhe analizimi i informacionit të ndryshuar në këtë mënyrë.

- Gjymtyrët e fjalisë ( kryefjala, kallzuesi )

Shkurtimi i fjalive deri tek kryefjala dhe kallzuesi.

Vërejtja e informacioneve shtesë që mundësohen nëpërmjet kundrinorëve.

Njohja e pjesëve më të rëndësishme të ligjëratës:

- Folja

Ballafaqimi i kohëve më të rëndësishme, analizimi i ndryshimeve të formës së tyre.

Ndryshimet në kohën e shkuar të tregimit gojor ( e kryer – ich habe gespielt = unë kam luajtur ) dhe kohës së shkuar në tregimin me shkrim ( e pakr., e kr. E thj. – ich spielte = unë luaja, unë luajta ).

- Emri

Zbulimi në tekst i rasave të ndryshme të emrit.

Njohja e katër rasave të emrit.

- Përemri si zëvendësues i emrit

Zëvendësimi me gjeste i përemrave në lojra dhe biseda.

Zëvendësimi i emrave me përemra.

- Mbiemri

Renditja e tipareve të caktuara të frymorëve dhe sendeve.

Konstatimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve me ndihmën e mbiemrave.

Ilustrimi i formave krahasuese ( Niveli fillestar, niveli mesatar, niveli i përparuar ).

Vështrim mbi fjalëformimin dhe kuptimit leksikor të fjalës:

- Bashkimi i fjalëve

Formimi i fjalëve të përbëra nga pjesë të ndryshme të ligjëratës: folje + emër (p.sh. kaufen – Haus: Kaufhaus; ) emër + mbiemër ( p.sh. Kohle – schëarz: kohlschëarz ).

- Para- dhe prapashtesat

Formimi i fjalëve nëpërmjet para- dhe prapashtesave

- Familjet e fjalëve

Grumbullimi i fjalëve që i përkasin të njëjtës familje dhe renditja në pjesët e njohura të ligjëratës

- Fjalët që i përkasin një fushe të caktuar

Grumbullimi i fjalëve me kuptim të afërt (p.sh. sich fortbeëegen) dhe përshkrimi i dallimeve në kuptimin e tyre

Parimet didaktike:

Të folurit:

Pikënisja e të mësuarit të gjuhës si edhe e nxitjes së orientuar të zhvillimit gjuhësor të fëmijëve në shkollën fillore, janë eksperiencat e mëparshme gjuhësore të fëmijës. Në të gjitha situatat e të mësuarit të gjuhës del i domosdoshëm zgjimi dhe forcimi i besimit të fëmijës tek aftësitë e veta gjuhësore. Që të shmangen ose të eliminohen ngurrimet gjuhësore, duhet që orientimi në format e gjuhës standarte të mos realizohet në asnjë mënyrë i sforcuar. Shtytje të shumta për të folur si edhe një orientim i kujdesshëm në përdorimin e saktë të tij zgjerojnë aftësitë gjuhësore të fëmijës.

Biseda:

Biseda është një formë më e avancuar e të folurit. Ajo ngre pretendime të mëdha për të gjithë pjesëmarrësit dhe parakupton sigurimin e një klime të përshtatshme bisedash. Kjo realizohet nëpërmjet: pranimit dhe nxitjes thelbësore të shprehjeve të nxënësve në gjuhën e tyre amëtare, të një të dëgjuari aktiv dhe të vëmendshëm të mësuesit, të pakësimit të interesimit të tepruar gjuhësor të tij, kjo e konceptuar nga ai në të mirë të fëmijës. Në të gjitha format e komunikimit gojor duhet që nëpërmjet krijimit të kushteve të jashtme të favorshme (vendosja e favorshme e bankave, formimi i grupeve) të garantohet një kontakt i përshtatshëm i fëmijëve me njëri-tjetrin.

Ushtrimi i të folurit: ( Rritja dhe zgjerimi i aftësisë gjuhësore )

Ushtrimi i të folurit bazohet mbi potencën gjuhësore që fëmijët e kanë fituar në familjen e tyre si edhe në mjedisin gjuhësor përreth. Kalimi nga dialekti ose gjuha bisedore rajonale në gjuhën standarte letrare duhet të realizohet pa shkëputje. Për rritjen e aftësisë gjuhësore të fëmijëve është e rëndësishme që temat e bisedave të shkëputen nga bota e eksperiencave të tyre ose nga fusha

që ngjallin interes për ta. Cdo zhvleftësim i gjuhës amëtare të fëmijës duhet mënjauar. Për zhvillimin e aftësisë gjuhësore të tyre u nevojitet shumicës së nxënësve një ushtrim i orientuar i të folurit, megjithatë këtu duhen shmangur mundësisht format e të ushtruarit mekanik. Një rëndësi të madhe ka edhe gjuha e përdorur nga mësuesi. Në të folur mësuesi duhet të bëj kujdes, që modelet e të folurit të tij të nxisin nga njëra anë zhvillimin gjuhësor të fëmijëve por nga ana tjetër shprehjet e përdorura të jenë të kuptueshme për fëmijët.

Të lexuarit e avancuar:

Pasi mesimi i të lexuarit ndodh në mënyrë shumë individuale, procesi i kalimit nga mësimi i hapave të para të leximit në një lexim të avancuar, do të zhvillohet për fëmijë të vecantë në momente të ndryshme. Prandaj nga njëra anë do të trajtohen ushtrime për rritjen e shkathtësisë së të lexuarit deri në fund të nivelit të parë fillestar, dhe nga ana tjetër për nxënës të veçantë do të mundësohet që herët takimi dhe konfrontimi i tyre me tekste të ndryshme. Në mësimin e leximit në nivelin e dytë fillestar, nxënësit duhet të kuptojnë gjithnjë e më shumë që nëpërmjet të lexuarit dhe konfrontimit me informacionin e marrë nga ajo ç'ka lexojnë, përveç eksperiencave jetësore reale ata thellojnë edhe aftësinë për të kuptuar vehten dhe të tjerët, gjithashtu kanë mundësi të informohen dhe të informojnë.

Takimi dhe konfrontimi me tekste të llojeve të ndryshme i shërbejnë edhe ravijëzimit të pjekurisë së të lexuarit. Në këtë kuadër duhet zgjeruar dhe forcuar shkathtësia e të lexuarit tek nxënësit.

Të shkruarit:

( Vetëm për nivelin e parë fillestar )

Si rregull, fëmija që para hyrjes në shkollë ka grumbulluar tashmë përvoja në marrdhënie me materialet e shkruara. Por nuk duhet nënvleftësuar fakti që muskulatura që realizon të shkruarin, aparati mbështetës i dorës që shkruan, komandimi i lëvizjeve dhe aftësia koordinuese e nxënësve që hyjnë për herë të parë në shkollë nuk janë zhvilluar plotësisht dhe niveli i arritur i zhvillimit të këtyre proçeseve brenda një klase, shfaq ndryshime të ndjeshme. Kështu për hapat e para të mësimin të të shkruarit, lind nevoja e një diferencimi dhe një parashkollimi me bazë. Nëpërmjet këtij nxënësi përgatitet për procesin e vërtetë të të shkruarit si edhe për kuptimin e funksionit të shkrimit. Fëmijët që shquhen për përdorimin e dorës së majtë

gjatë të shkruarit nuk duhet të detyrohen të shkruajnë me dorën e djathtë. Në raste të veçanta mësuesi mund të nxis me shumë kujdes të shkruaj me dorën e djathtë.

Hartimi i teksteve:

Procesi i hartimit të teksteve lidhet me gadishmërinë e fëmijës për të informuar dhe nga nevoja e tij për të rregjistruar dicka me shkrim.

Në këtë proces kompleks të mësuarit ndikojnë drejtpërdrejtë edhe nëndisiplinat e tjera, vecanërisht të folurit, të shkruarit dhe drejtshkrimi. Kështu hartimi i teksteve ngre pretendime të mëdha tek fëmija.

Gjendja fillestare dhe ecuria e mëtejshme e nxënësit në këtë fushë është shumë individuale dhe ndryshon nga njëri nxënës tek tjetri, dhe për këtë arsye duhet që kërkesat ndaj nxënësit në volum dhe pavarësi në shkrimet e tij, si edhe masat nxitëse në mësim që i përgjigjen aftësisë gjuhësore motorrike ( po ashtu edhe aftësisë për të shkruar duke zbatuar të gjitha rregullat e drejtshkrimit ) duhen diferencuar nga fjalori dhe struktura e fjalisë.

Tekstet e nxënësve të nivelit të parë fillestar nuk duhen vlerësuar dhe gjykuar në asnjë mënyrë duke u nisur nga mangësitë e tij në zbatimin e rregullave të drejtshkrimit.

Përkundrazi çdo detyrë me shkrim duhet organizuar në mënyrë të tillë që nxënësit gjatë hartimit të tekstit ose para dorëzimit të tij të mund të mund të pranojnë në ndonjë rast mëdyshjeje rrugëzgjidhje leksikore. Shkrimet e pasigurta mund kthehen më pas në pengesa të mësimit vijues të drejtshkrimit. Por edhe nxënësit e nivelit të parë fillestar mund t'i lexojnë mësuesit historinë e tyre.

Mësuesit i del si detyrë të pikasë rastet e përshtatshme të të shkruarit.

Gjatë procesit të hartimit të një teksti, nxënësit duke u bazuar dhe në gadishmërinë e tyre për të informuar si edhe në aftësitë e fituara në procesin e të folurit, të shkruarit dhe drejtshkrimit, mund të shprehin me shkrim, dhe kjo si duke ju referuar vehtes, p.sh. përshkrimi i përjetimeve, i vrojttimeve ashtu edhe duke ju referuar partnerit, p.sh. urimet, pyetjet.

Edhe në nivelin e dytë fillestar, gadishmëria e fëmijës për të informuar krijon një bazë të sigurtë për të mësuarin në këtë fushë. Aftësia për të shprehur, paraqitur dicka me shkrim si edhe për të informuar të tjerët nuk shfaqet e njëjtë dhe kjo për shkak të varësisë nga nëndisiplinat e tjera kryesisht të shkruarit, të folurit dhe drejtshkrimit. Prandaj si procesi i vërtetë i hartimit të tëksteve ashtu edhe ushtrimet e tij shoqëruese duhen

diferencuar, kjo në përshtatje me kërkesat individuale të nxënësit për të mësuar.

Në përputhje me rritjen e aftësisë së tyre në procesin e të folurit, të shkruarit dhe drejtshkrimit nxënësit tashmë në vazhdimësinë e pandërprerë të punës së tyre në nivelin e parë fillestar, mund të shprehen të pavarur me shkrim dhe kjo gjithnjë rreth vehtes së tyre, rreth partnerëve ose rreth temës.

Drejtshkrimi:

Të mësuarit e drejtshkrimit është një proces kompleks i cili është i lidhur ngushtë me nëndisiplinat e tjera në mësimin e gjermanishtes.

Kështu nxënësi përpara se të ketë përvetësuar të shkruarin e një fjale sipas normave gjuhësore, më parë ai duhet të jetë në gjendje të kuptoj domethënien e kësaj fjale ( Të folurit ). Përveç kësaj nxënësi duhet të jetë në gjendje të perceptojë pjesët përbërëse tingullore të një fjale ( fonemat ) dhe renditjen e tyre si edhe të rendisë grafemat ( Hapat e parë të të lexuarit ). Si përfundim duhet të jenë mësuar format themelore të shkrimit dhe të mund të lexohet ajo cka është shkruar ( Të shkruarit, të lexuarit ).

Mësimi i drejtshkrimit, në nivelin e parë fillestar i jep një rëndësi të madhe praktikimit dhe zotërimit të sigurtë të një fjalori të kufizuar më i përdorshëm gjatë të shkruarit, kjo për të mënjanuar një përvetësim sipërfaqësor të shumë fjalëve.

Fjalët duhen praktikuar në bashkime të ndryshme, në variante të ndryshme tekstesh si edhe në situata të shumëanëshme të të mësuarit.

Përbërësit thelbësor të procesit të të mësuarit janë:

- Të kuptuarit e domethënies së fjalëve,
- Perceptimi i vetëdijshëm i fonemave,
- Ngulitja e të shkruarit sipas normave gjuhësore,
- Të ushtruarit me bazë të rrjedhës së zhvendosjes.

Por mënyrat njëdimensionale të ndërmjetësimit nuk mund ta zgjidhin kënaqshëm këtë detyrë.

Prandaj nëpërmjet bashkëvendosjes së formave të të njëjtit lloj bëhen të qarta fenomene të caktuara të drejtshkrimit. Atëherë ballafaqimi i formave të ndryshme të të shkruarit ka kuptim nëse ky është i domosdoshëm si një rrugëzgjdhje ose nëse prej këtij veprimi rezulton një siguri në drejtshkrim ( p.sh. Larche – Lerche; gut – das Gute; schreiben – beim Schreiben ). Më i pakuptimtë shfaqet ballafaqimi tek përcaktimi ose mospërcaktimi i gjatësisë së zanoreve ( p.sh. fjalët me “a” – “aa” – “ah” ose “i” – “ie” – “ih” ).

Ndërmjetsimi i shenjave të pikësimit duhet parë ne lidhje të ngushtë me vrojtimin gjuhësor.

Në nivelin e dytë fillestar duhet të vazhdoj procesi i ndërmjetsimit rrënjësor të një fjalori të kufizuar që shfaqet kryesisht në të shkruar. Nëpërmjet masave të shumëanshme metodike mbi bazën e këtij fjalori do të rritet dhe zgjerohet aftësia drejtshkrimore e nxënësit.

Procesi i bashkërendimit të formave të të njëjtit lloj duhet të na udhëheq në formulimin e rregullave; të cilat duhet të përdoren nga nxënësit.

Procesi i ndërmjetësimit të një teknike mundësisht të zhdërvjellët të shfletimit bën që nxënësit të ambjentohen më shpejt dhe më kollaj me përdorimin e fjalorit si një ndihmesë e besueshme për zgjidhjen e problemeve të drejtshkrimit. Kjo teknikë duhet përdorur në të gjitha detyrat me shkrim, p.sh. në korrigjimin e diktimeve.

Përdorimi i fjalorit duhet ndërmjetësuar madje edhe në detyrat e klasës.

Në gjykimin e konstatimeve me shkrim të rezultateve, të cilat nuk i shërbejnë vetëm kontrollit të njohurive të caktuara mbi drejtshkrimin, është për t'u marrë parasysh këshillimi në kapitullin e 15-të mbi gjykimin e rezultateve.

## Vrojtimi gjuhësor

### Niveli i parë fillestar

Premisa për ndërgjegjësimin mbi strukturat gjuhësore garanton një lloj sigurie në përdorimin e gjuhës. Pasi përveç kësaj aftësia e shumicës së nxënësve në nivelin e parë fillestar kushtëzohet dhe kufizohet nga eksperiencat e tyre konkrete, procesi i vrojtimit gjuhësor merr më pak rëndësi se zgjerimi i aftësisë gjuhësore.

Vrojtimi gjuhësor përdoret kryesisht në ato raste, kur bëhet e mundur nxitja e një ndjenje kënaqësie në përjetësimet gjuhësore dhe në marëdhëniet me elementët gjuhësorë. Kjo përjashton theksimin e tepërt në formimin gramatikor të termave.

### Niveli i dytë fillestar

Edhe në nivelin e dytë fillestar premisa për ndërgjegjësimin mbi strukturat gjuhësore garanton një llojë sigurie në përdorimin e gjuhës.

Pasi aftësia e nxënësve për formimin e abstraktave dhe termave të ndryshme zhvillohet përkatësisht në nivelin e dytë fillestar, vrojtimi gjuhësor me përjashtim të vrojtimin të fenomeneve gjuhësore të asimilueshme lehtë që shfaqen në orën e mësimin, rezervon nivelin e tretë dhe të katërt shkollor; por edhe këtu qëllimi i të mësuarit nuk është zotërimi mirë i abstraktave dhe termave sipërfaqësore.

Vrojtimi gjuhësor realizohet mundësisht në kuadrin e formave të tilla të mësimin, në saj të të cilave nxënësit ndërgjegjësohen mbi strukturat gjuhësore, kjo nëpërmjet zbulimit, rradhitjes dhe krahasimit. Kështu si gjuha e folur ashtu edhe ajo e shkruar bëhen objekt i vrojtimin.

Terminologjia profesionale hyn në zbatim vetëm atëherë kur nxënësit nëpërmjet kontaktit me materiale gjuhësore, kanë dalluar një formë gjuhësore me funksionin e saj. Në rast se terminologjinë profesionale fillojnë të përdoren tepër herët, pa shqyrtimin e detajuar përkatës, atëherë ato mbeten gjithmonë vetëm mbeturina fjalësh. Gjatë një emërtimi të parë, mund të merren me vete edhe paraterma. Mësuesi nga ana e tij duhet të përpiqet që gjatë vënies në zbatim të këtyre terminologjive, të shmang përdorimin e kuptimeve leksikore të sipërfaqshme që dalin në orën e mësimin, të cilat realizojnë një përshkrim orientues dhe të pamjaftueshëm të fenomeneve gramatikore.

Në vitin e katërt shkollor duhen siguruar terminologjinë më të rëndësishme profesionale. Edhe në këtë nivel shkollor duhet mënjanuar theksimi i tepërt i njohurive gramatikore mbi termat.

Të lexuarit

Të lexuarit për herë të parë

Nxënësit fillestarë shfaqin në lidhje me procesin e të lexuarit premisa të ndryshme. Këto i balancon mësimi i të lexuarit nëpërmjet ofertave të diferencuara të të mësuarit. Sidoqoftë, fitimin të rezultateve bazë të domosdoshme për mësimin e të lexuarit nga çdo nxënës, i duhet kushtuar një vëmendje e vecantë, që do të thotë se mësimi i të lexuarit duhet filluar vetëm atëhere kur secili nxënës (grup nxënësish) ka arritur rezultatet bazë të domosdoshme për mësimin e të lexuarit. Mësimi i të lexuarit të parë duhet të mundësoj jo vetëm fitimin e këtyre bazave por edhe mësimin e të lexuarit në kuptimin e ngushtë të fjalës, pra në situata dhe nëpërmjet mjeteve të përshtatshme mësimore. Fëmijës duhet t'i lihet në dispozicion një kohë e

Plani mësimor I shkollës popullore, pjesa e shtatë, detyrat formuese dhe mësimore si dhe lënda mësimore dhe parimet didaktike të materialeve të detyrueshme të shkollës popullore dhe të nivelit të lartë të shkollës popullore, shkolla fillore – gjermanisht, leximi, shkrimi /gjermanisht, leximi Gjëndja : shtator 2001

mjaftueshme për të mësuar dhe duhet t'i krijohet hapësirë e mjaftueshme procesit të vetëzbulimit.

Ushtrimet për rritjen e aftësisë së të lexuarit dhe të lexuarit si disiplinë duhet të jenë të larmishme dhe të ndërthurura në mënyrë sa më jetësore që të jetë e mundur gjatë mësimin. Kapja e kuptimit dhe kënaqësia e të lexuarit duhet t'a udhëheqin mësimin që nga fillimi i tij ku mund të mbartet edhe një lexim i tërësishëm (“naiv”, “i kuptueshëm”). (p.sh. të lexuarit e vargjeve për fëmijë, të cilat fëmijët mund t'i dinë përmendësh; kartat e vogla ku fëmijët shkruajnë e mrin e tyre; shënimet; pllakatat; tabelat ndaluese ose lejuese).

**Perkthyer nga: Eneida Dobruna**  
**Perkthimi u mundësua nga SEE ECN.**